

Në bazë të nenit 37, paragrafi (1), nënparagrafi (4) të Ligjit të Gjykatave (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06, nr.35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe Gazeta Zyrtare të RMV” nr.96/19), Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e përgjithshme të mbajtur më 24.12.2021, miratoi

RREGULLORE
të punës së Gjykatës Supreme
të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kreu I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Rregullore) rregullohet organizimi dhe mënyra e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Neni 2

Me organizimin dhe mënyrën e punës së Gjykatës sigurohet ushtrimi i funksionit në mënyrë ligjore, të pavarur, të paanshëm, efikas dhe në afat të arsyeshëm, realizimi pa pengesë i të drejtave dhe obligimet e palëve, pa dallim pozitës dhe cilësisë së tyre.

Neni 3

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në punën e saj i zbaton dispozitat nga Rregullorja gjyqësore për çështje të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore.

Neni 4

Kryetari i Gjykatës dhe administratori gjyqësor e sigurojnë zbatimin e Rregullores.

Gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësorë, në punën e vet, drejtpërdrejt e zbatojnë Rregulloren.

Neni 5

Funksioni i gjyqtarit në Gjykatën ushtrohet përmes këshillave gjyqësorë, sektorëve gjyqësorë, seancave të përbashkëta gjyqësore, seancave të gjyqtarëve dhe seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Selia e Gjykatës është në Shkup. Në ndërtesën në të cilën është e vendosur Gjykata, shkruhet emri “Republika e Maqedonisë së Veriut, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut” me stemën dhe flamurin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Emri i Gjykatës shkruhet në tabelë të posaçme qelqi, e cila ka formë drejtkëndëshi me dimensione prej 70cm x 35cm. Teksti është shënuar me shkronja të mëdha me ngjyrë ari në fushë të zezë. Tabelat dygjuhësore janë me dimensione më të mëdha, së pari është shënuar teksti në gjuhën maqedonase, pastaj në gjuhën ndryshe nga gjuha maqedonase që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në tabelën e Gjykatës mund të shkruhet emri i Gjykatës në njërin nga tri gjuhët e përdorura më shpesh në Bashkimin Europian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht).

Neni 7

Gjykata ka vulën e vet në formë të rrethit me diametër prej 40 mm.

Vula përmban stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut rreth të cilës është teksti “Republika e Maqedonisë së Veriut – Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup”, në të cilën së pari është shënuar teksti në gjuhën maqedonase, pastaj në gjuhën ndryshe nga gjuha maqedonase, që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vula e Gjykatës vendoset në vendimet që miratohen nga ana e Gjykatës, si dhe në të gjitha aktet tjera zyrtare.

Gjykata ka vulë katrore drejtkëndësh me diametër prej 60 mm.

Vula katrore përmban tekstin “Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, numri, data, Shkup, në të cilën së pari është shënuar teksti në gjuhën maqedonase, pastaj në gjuhën ndryshe nga gjuha maqedonase, që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në komunikimin ndërkombëtar, emri i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe shenja e shkurtesës GJSRMV, krahas gjuhës maqedonase, pastaj në gjuhën ndryshe nga gjuha maqedonase, që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të shkruhet edhe në njërin nga tri gjuhët e përdorura më shpesh në Bashkimin Europian (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht).

Kreu II

ORGANIZIMI I GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1. KRYETAR I GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 8

Kryetari i Gjykatës ka statusin dhe funksionin e gjyqtarit të parë në Gjykatë, e organizon punën dhe e përfaqëson Gjykatën para organeve shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, organeve tjera vendore dhe ndërkombëtare dhe organizatave.

Kryetari i Gjykatës është përgjegjës edhe për kohën e punës së Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës kryen punët nga fushëveprimi i administratës gjyqësore, e organizon punën, udhëheq dhe menaxhon me Gjykatën.

Për kryerjen e punëve me sukses, në kohë dhe në rregull të administratës gjyqësore, kryetari i Gjykatës mund t'ia besojë detyrat e punës zëvendësit të tij ose ndonjë gjyqtari tjetër, gjyqtarit kryetar të sektorit, administratorit gjyqësor ose ndonjë nëpunësi tjetër, udhëheqës gjyqësor dhe sipas nevojës ta organizojë edhe ekipin e tij për punë.

Në rast të pengesës ose mungesës, kryetarin e Gjykatës e zëvendëson zëvendësi i kryetarit të Gjykatës.

Neni 9

Kryetari i Gjykatës e përcakton orarin vjetor të punës së gjyqtarëve, pas mendimit paraprakisht të siguruar nga seanca e përgjithshme.

Me Orarin vjetor caktohet se në cilën sferë gjyqtari do ta ushtrojë funksionin e gjyqtarit.

Gjyqtari nuk mund të zhvendoset nga njëri sektor në një sektor tjetër kundër dëshirës së vet.

Në raste të veçanta, për shkak të zgjedhjes së një gjyqtari të ri, mungesës së zgjatur të gjyqtarit, vëllimit dukshëm të madh ose të zvogëluar të lëndëve gjatë vitit në punë në sfera të caktuara juridike ose vendeve të zbrazura të gjyqtarëve, gjyqtari mund që gjatë vitit të zhvendoset në punë nga një sektor në një sektor tjetër, por jo më gjatë se 1 vit.

Me orarin vjetor të punës së gjyqtarëve përcaktohet zëvendësi i kryetarit të Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës merr vendim për zbatimin e orarit vjetor të punës së gjyqtarëve në programin AKMIS, në pajtim me Rregulloren gjyqësore.

Kryetari i Gjykatës miraton vendim për formimin e këshillit me kohë në raste kur këshilli nuk mund të veprojë në pajtim me orarin vjetor të punës.

Neni 10

Kryetari i Gjykatës mund të propozojë punë të caktuara dhe detyra nga kompetenca e Gjykatës që të shqyrtohen në seancën e gjyqtarëve, që të ndërmerren masa në përparimin e funksionimit më efikas të Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës e ndjek situatën me ecurinë e lëndëve në Gjykatë drejtpërdrejt dhe në bazë të parashikimeve dhe raporteve të sektorëve gjyqësorë.

Neni 11

Kryetari i Gjykatës, sipas nevojës, mban takime pune me kryetarët e Gjykatës së Lartë Administrative, të Gjykatës Administrative, kryetarët e gjykatave themelore dhe të apelit lidhur me punën e gjykatave, zbatimin e Rregullores gjyqësore dhe për çështje tjera të rëndësishme për gjyqësorin, si dhe takime me përfaqësues të organeve dhe organizatave tjera për çështje me kuptim të gjyqësorit.

Neni 12

Për informimin dhe njoftimin në kohë me punën vijuese dhe me çështjet aktuale në sektorët gjyqësorë, konsultime lidhur me përpilimin e propozimeve për seancat e gjyqtarëve, dhe të Seancës së përgjithshme dhe për shkak të grumbullimit të mendimeve për çështje nga kompetenca e kryetarit të Gjykatës, sipas nevojës, ai mban takime punuese ose takime të caktuara me kryetarët e sektorëve gjyqësorë dhe me kryetarët e këshillave gjyqësorë.

Neni 13

Kryetari i Gjykatës mund të lejojë prioritet në vendimmarrjen për lëndë të veçanta në bazë të kërkesës me shkrim të palës. Lëndët me prioritet të lejuar i dorëzohen gjyqtarit pa prolongim.

Kryetari i Gjykatës mund të lejojë prioritet për vendimmarrje për lëndë të veçanta në bazë të kërkesës së arsyetuar me shkrim të gjyqtarit, të kryetarit të këshillit ose të kryetarit të sektorit.

Neni 14

Kryetari i Gjykatës miraton vendim për orarin e gjyqtarëve si gjyqtarë referues që e ndjekin punën e Gjykatës së Lartë Administrative, Gjykatës Administrative, gjykatave themelore dhe gjykatave të apelit.

Gjyqtari referues nga paragrafi (1) njëkohësisht është edhe gjyqtar referues për kundërshtim të gjyqtarit nga ajo gjykatë.

Neni 15

Kryetari i Gjykatës miraton program për vizitën e gjykatave pas mendimit paraprakisht të siguruar nga Seanca e gjyqtarëve.

2. GJYQTARI QË E ZËVENDËSON KRYETARIN

Neni 16

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me orarin vjetor të punës së gjyqarëve, përcakton gjyqtar, i cili do ta zëvendësojë në rast të pengesës dhe mungesës së tij.

Në raste të mungesës së gjyqtarit që e zëvendëson kryetarin e Gjykatës, do ta zëvendësojë gjyqtari që është më i moshuar sipas zgjedhjes në Gjykatë.

3. KABINETI I KRYETARIT TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 17

Për realizimin e punëve administrativo-teknike për nevojat e kryetarit të Gjykatës, organizohet Kabineti i kryetarit të Gjykatës.

4. GJYQTARË TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 18

Gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë në këshilla, në sektorë gjyqësorë, në seanca të përbashkëta të sektorëve, në seanca të gjyqarëve dhe në Seancë të përgjithshme.

5. SEKTORËT GJYQËSORË

Neni 19

Në Gjykatë themelohen 4 (katër) sektorë gjyqësorë:

1. Sektori i veprave penale
2. Sektori i veprave civile
3. Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm
4. Sektori i praktikës gjyqësore.

Neni 20

Sektorin e veprave penale e përbëjnë kryetari i Sektorit, gjyqtarët dhe nëpunësit profesionalë gjyqësorë, të cilët me orarin vjetor të punës janë sistemuar që t'i realizojnë punët në këshillat e Sektorit dhe nëpunësit administrativë në zyrën e shkresave të Sektorit.

Sektorin e veprave civile e përbëjnë kryetari i Sektorit, gjyqtarët dhe nëpunësit profesional gjyqësorë që me orarin vjetor të punës janë sistemuar që t'i realizojnë punët në këshillat e Sektorit dhe nëpunësit administrativë në zyrën e shkresave të Sektorit.

Sektorin e gjykimit në afat të arsyeshëm e përbëjnë kryetari i Sektorit, gjyqtarët dhe nëpunësit profesional gjyqësorë që me orarin vjetor të punës janë sistemuar që t'i realizojnë punët në këshillat e Sektorit dhe nëpunësit administrativë në zyrën e shkresave të Sektorit.

Sektorin e praktikës gjyqësore e përbëjnë kryetari i Gjykatës, kryetari i Sektorit të praktikës gjyqësore, kryetarët e sektorëve tjerë dhe nëpunësit profesionalë gjyqësorë nga tre sektorët gjyqësorë të obliguar për ndjekjen e praktikës gjyqësore.

6. PUNA E GJYKATËS

Neni 21

Punët nga kompetenca gjyqësore, të shënuara me Kushtetutën dhe Ligjin e Gjykatave, në Gjykatë realizohen përmes:

- këshillave,
- seancës së sektorëve,
- seancës së përbashkët të sektorëve,
- seancës së gjyqtarëve,
- Seancës së përgjithshme,
- Seancës së përgjithshme të zgjeruar.

7. KËSHILLA GJYQËSORË

Neni 22

Këshillat vendosin për lëndë konkrete nga kompetenca e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Gjykatës me orarin vjetor të punës e cakton numrin dhe përbërjen e këshillave, i përcakton kryetarët e këshillave dhe anëtarët, si dhe zëvendësit e tyre në rast të mungesës ose parandalimit.

Neni 23

Çdo lëndë e re e formuar nga zyra e shkresave të sektorëve, që është shpërndarë te një gjyqtar i caktuar, nëpunësi gjyqësor ditën e ardhshme e dorëzon dhe në mënyrë elektronike e lëviz lëndën te gjyqtari.

Gjyqtari, në bashkëpunim me nëpunësin profesional gjyqësor, e shqyrton lëndën me qëllim që të konstatojë nëse janë plotësuar supozimet procedurale për vendimmarrjen mbi mjetin e deklaruar juridik.

Kur nuk është plotësuar ndonjëra nga supozimet procedurale dhe se lënda duhet të kthehet në gjykatën më të ulët, ose në qoftë se mjeti juridik është jo në kohë, i paarsyetuar ose i palejuar, gjyqtari referues atë do ta paraqesë në seancën e parë të këshillit.

Në qoftë se nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi (3) të këtij neni, lënda do të kthehet në zyrën e shkresave.

Përgatitja e lëndëve për seancë të këshillit

Neni 24

Gjyqtari referues në bashkëpunim me nëpunësin profesional gjyqësor, përpilon raport me shkrim lidhur me lëndën konkrete.

Raporti me shkrim përmban gjendjen faktike, arsyetim juridik, me rishikim të veçantë të çështjeve faktike dhe kontestuese juridike dhe të dhënat në mjetin juridik për të cilin vendoset.

Raporti me shkrim me materialin e nevojshëm: vendimi i shkallës së parë, vendimi i shkallës së dytë, ankesa, mjeti juridik i deklaruar dhe material tjetër, sipas vlerësimit të gjyqtarit referues për kryetarin dhe anëtarët e këshillit, dorëzohet në formë elektronike dhe në formë të shtypur më së voni 8 ditë para ditës kur lënda do t'i prononcohet këshillit.

Puna e këshillave

Neni 25

Me seancën e këshillit udhëheq kryetari i këshillit, që e formon këshilli nga gjyqtarët e vendosur në atë këshill, me parimin e ndërrimit sipas radhitjes për zgjedhje në këtë Gjykatë.

Deri në nënshkrimin e vendimit, kryetari i këshillit dhe çdo anëtarë i këshillit kanë të drejtë që të kërkojnë që lënda përsëri të paraqitet para këshillit.

Arsyet për të cilat kërkohet që lënda përsëri të paraqitet para këshillit duhet të jenë të arsyetuara në formë të shkruar.

Neni 26

Gjatë miratimit të vendimit, këshilli vlerëson nëse mendimi juridik i miratuar do të duhet të regjistrohet në evidencën e praktikës gjyqësore me shenjën “ev” në kopertinën e shkresave.

Neni 27

Çdo seancë e këshillit evidentohet në librin e seancave.

Në librin e seancave shënohen: dita e mbajtjes së seancës, përbërja e këshillit, numri i lëndës, mjeti juridik, përkatësisht baza për të cilën është vendosur, lloji i vendimit dhe numri i votave me të cilën është miratuar.

Libri i seancave për punën e këshillit ruhet te kryetari i këshillit.

Për çdo lëndë që është diskutuar, përpilohet shënim nga procesi në AKMIS-programin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilin shënohen: numri me të cilin udhëhiqet lënda në Gjykatë, data e mbajtjes së seancës, emri dhe mbiemri i kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit, të gjykatësit referues dhe procesverbalisti, lloji i mjetit juridik për të cilin vendoset dhe çfarë vendimi është miratuar në formë të shkurtër (aktgjykim, aktvendim ose anulimin të seancës).

Neni 28

Kur këshilli do të vlerësojë se mbi çështjen juridike për të cilën vendos duhet të miratohet mendim juridik, për shkak të sigurimit të unitetit në zbatimin e ligjit, për atë e njofton kryetarin e sektorit dhe e ndërpret punën për lëndën, deri sa mbi atë çështje nuk diskutohet në seancë të sektorit.

Nëse në seancën e sektorit nuk miratohet mendimi i propozuar juridik, propozimi për miratim të mendimit juridik i dorëzohet kryetarit të Gjykatës dhe propozimi vendoset për shqyrtim dhe diskutim në Seancë të përgjithshme.

Kur anëtarët e këshillit do të vlerësojnë se për lëndën që diskutojnë duhet të shmanget nga qëndrimi që është shprehur në vendimin e miratuar paraprak të Gjykatës, do të kërkojnë nga kryetari i sektorit të thirr mbajtje të seancës së sektorit. Sektori i seancës vendos nëse nevojitet që çështja juridike të paraqitet në Seancë të përgjithshme.

Nëse këshilli në marrjen e vendimit vlerëson se duhet të ngrihet procedurë për ndryshim të ligjit që zbatohet, për miratim të qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor, dorëzohet propozim drejtuar kryetarit të Gjykatës, ndërsa ai e inicion shqyrtimin në Seancën e përgjithshme.

Mbi çështjen kontestuese, e cila duhet të shqyrtohet në seancën e sektorit, gjyqtari referues përgatit material me shkrim, që u dërgohet gjyqtarëve dhe nëpunësve profesional gjyqësor të sektorit, me ftesë për seancën e caktuar të sektorit.

Neni 29

Originali i vendimit, së bashku me lëndën, dërgohen për këqyrje në Sektorin e praktikës gjyqësore, para se të bëhet verifikimi i vendimit.

Sektori i Praktikës gjyqësore bën kontrollimin e çdo vendimi të dorëzuar dhe në qoftë se vendimi nuk është në kundërshtim me qëndrimet e marra juridike në disa vendime të kaluara, do të shënojë në kopertinën e lëndës se është bërë kontrollimi, ashtu që vendimi dhe shkresat kthehen në zyrën e shkresave gjyqësore, që të bëhet verifikimi dhe ekspedimi i vendimit.

Në qoftë se Sektori i Praktikës gjyqësore konstaton se është miratuar vendim që është në kundërshtim me praktikën e gjykatës dhe me qëndrimet e marra juridike, për atë do ta njoftojë kryetarin e këshillit, i cili përsëri e paraqet lëndën për shqyrtim dhe vendimmarrje para këshillit.

Në qoftë se këshilli nuk e ndryshon vendimin gjatë ri vendimmarrjes, lënda i drejtohet kryetarit të sektorit, për shqyrtim të saj në seancën e sektorit.

8. SEKTORËT GJYQËSORË

Puna e sektorëve gjyqësorë

Neni 30

Sektori ka kryetar dhe zëvendës të kryetarit nga radha e gjyqtarëve, ndërsa sekretar nga radha e nëpunësve profesionalë gjyqësor.

Kryetari i sektorit siguron që punët e sektorit të realizohen në rregull me kohë.

Neni 31

Sektori punon në seancë të sektorit.

Seancat i thërret kryetari i sektorit me vetiniciativë, me kërkesë të gjyqtarëve të sektorit ose të kryetarit të Gjykatës.

Neni 32

Seanca e sektorit thërritet edhe kur ndërmjet këshillave të caktuar nuk ka unitet në zbatimin e ligjit ose nëse një këshill shmanget nga qëndrimi parimor ose nga mendimi juridik parimor, mendimi juridik i konstatuar në seancë të këshillit ose nga praktika e pranuar nga ana e të gjithë këshillave.

Në seancën e sektorit çështjet kontestuese juridike shqyrtohen në bazë të referatit, me propozimin e mendimit juridik, që dorëzohet me ftesë për seancën e sektorit.

Iniciativë për marrjen e mendimit juridik mbi çështje juridike me interes për punën e këshillave gjyqësor në sektorin mund të parashtrojnë kryetari i sektorit, këshilli dhe gjyqtarët. Parashtruesi i iniciativës me shkrim e arsyeton nevojën për marrjen e mendimit juridik, në qoftë se paraprakisht nuk ka ekzistuar ose nevoja për ndryshim të mendimit juridik veç më të miratuar.

Në mënyrë të njëjtë veprohet kur sektori drejtuar Seancës së përgjithshme parashton iniciativë për ngritjen e procedurës për rregullimin ligjor të çështjeve individuale, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve veç më ekzistuese dhe

parashtrimin e iniciativës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera të përgjithshme.

Neni 33

Seanca e sektorit mund të mbahet nëse është i pranishëm dy e treta e shumicës nga gjyqtarët e sektorit.

Në seancën e sektorit votojnë vetëm gjyqtarët.

Kryetari i Gjykatës çdoherë mund të marrë pjesë në punën e seancës së sektorit.

Vendimi është i miratuar kur për të kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të sektorit.

Votimi është publik.

Në vendimmarrjen, gjyqtari nuk mund të jetë i përmbajtur.

Në seancën e sektorit thirren edhe nëpunësit profesionalë gjyqësor, që marrin pjesë në punën e seancës së sektorit.

Sekretari i sektorit e përgatit seancën e sektorit, ndërsa në mungesë të tij e përgatit zëvendësi i sekretarit.

Neni 34

Për punën e seancës udhëhiqet procesverbal, ku shënohen të gjitha mendimet e prononcuar në seancën, si dhe rezultati nga votimi.

Procesverbali në formë elektronike futet në dosje të veçantë që është në dispozicion për gjyqtarët e sektorit.

Procesverbalin e nënshkruan kryetari i sektorit që e ka udhëhequr seancën, sekretari ose nëpunësi profesional gjyqësor, që e ka udhëhequr procesverbalin.

Çdo seancë evidentohet në libër të veçantë të dedikuar për seanca të sektorit, ku evidentohet edhe përmbajtja e procesverbalit nga puna e seancës, që kur procesverbali të jetë i miratuar.

Neni 35

Projekt-mendimin juridik me arsyetim të pranuar në seancën e përgatit referuesi, dhe nëse propozimi i tij nuk pranohet, atëherë gjyqtari i caktuar në seancën.

Plani në mënyrë elektronike u dorëzohet të gjithë anëtarëve të sektorit.

Teksti përfundimtar përputhet në mënyrë elektronike.

Gjyqtari që nuk pajtohet me mendimin juridik të aprovuar mendimin e vet mund ta ndajë dhe t'ia bashkëngjisë origjinalit të mendimit juridik të miratuar.

9. SEANCË E PËRBASHKËT E SEKTORËVE GJYQËSORË

Neni 36

Në Gjykatë, sipas nevojës, organizohen edhe seanca të përbashkëta të sektorëve gjyqësorë.

Në seancat e sektorëve gjyqësorë shqyrtohen çështje me interes për punën e të gjithë këshillave, përkatësisht gjyqtarëve që janë në përbërje të sektorit, sidomos lidhur me zbatimin e ligjeve në sfera adekuate dhe unifikimin e praktikës gjyqësore dhe avancimin e metodës së punës.

Neni 37

Kur për vendimmarrjen e ndonjë çështje marrin pjesë dy sektorë, seancën e përbashkët e thërrasin me marrëveshje kryetarët e atyre sektorëve, ashtu që çdo sektor përcakton gjyqtar referues.

Me seancën e përbashkët udhëheq kryetari i sektorit në fushëveprimin e të cilit bie materia që është objekt diskutimi ose me marrëveshjen ndërmjet kryetarëve.

Neni 38

Për vendimmarrje të vlefshme në seancë të përbashkët të sektorëve, nevojitet prania e të paktën dy të tretave nga gjyqtarët e çdo sektori.

Mendimi juridik aprovohet me shumicën nga gjyqtarët e sektorëve.

Neni 39

Mendimi juridik prononcohet në Seancë të përgjithshme në rastet kur nuk do të arrihet numri i nevojshëm i votave në seancën e sektorit ose kur do të ketë qëndrime të ndryshme të dy sektorëve në seancën e përbashkët të sektorëve.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastet nëse këshilli gjatë vendimmarrjes së përsëritur nuk vepron në pajtim me mendimin juridik të sektorit. Në atë rast, kryetari i sektorit ka të drejtë ta ndërpresë vendimin, derisa nuk vendoset mbi atë çështje në Seancën e përgjithshme.

10. SEANCA E GJYQTARËVE

Neni 40

Seancën e gjyqtarëve e formojnë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës.

Seancën e gjyqtarëve e cakton dhe me atë udhëheq kryetari i Gjykatës.

Neni 41

Në seancën e gjyqtarëve shqyrtohen çështje organizative dhe çështje me kuptim të përgjithshëm për punën e Gjykatës, sektorëve gjyqësor dhe të gjitha çështjet tjera që janë me kuptim për funksionimin dhe përmirësimin e punës në Gjykatë.

Kryetari i Gjykatës i informon gjyqtarët për masat që do t'i ndërmarrë për qarkullimin më efikas të lëndëve në bazë të sugjerimit të trupit punues për qarkullimin e lëndëve dhe sugjerimit individual nga kryetarët e sektorëve.

Shqyrtohen raportet periodike për punën e Gjykatës, përcaktohet pjesëmarrja e gjyqtarëve në këshillime të ndryshme në vend dhe jashtë vendit, shqyrtohen informacionet nga vizitat e realizuara në vend dhe jashtë vendit, si dhe çështje që duhet të parashtrihen në Seancë të përgjithshme.

Kryetari i Gjykatës në seancën e gjyqtarëve i informon gjyqtarët për aktivitetet dhe kontaktet që i ka realizuar me organe tjera dhe organizata në vend dhe jashtë vendit, po ashtu edhe për njohuri dhe aktivitete tjera të rëndësishme nga kompetenca e vet.

Në seancën e gjyqtarëve, sipas rregullit marrin pjesë administratori gjyqësor, shefi i Kabinetit ose një nëpunës tjetër i shpërndarë me Orarin vjetor në Kabinetin e kryetarit të Gjykatës.

11. SEANCA E PËRGJITHSHME

Puna e Seancës së përgjithshme

Neni 42

Seancën e përgjithshme e formojnë kryetari i Gjykatës dhe të gjithë gjyqtarët në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me Seancën e përgjithshme udhëheq kryetari i Gjykatës dhe kujdeset për mbajtjen e rendit të seancës.

Në rast të pengesës të kryetarit të Gjykatës, me Seancën e përgjithshme kryeson gjyqtari që e zëvendëson kryetarin e Gjykatës.

Në rast të pengesës të kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit që e zëvendëson, Seancën e përgjithshme e udhëheq gjyqtari më i moshuar sipas zgjedhjes.

Neni 43

Në Seancë të përgjithshme gjyqtarët mbajnë veshje të posaçme për gjyqtarë (togë).

Gjyqtarët në sallën e Seancës së përgjithshme ulen sipas radhitjes në vazhdim: kryetari i Gjykatës ulet në vendin qendror të tavolinës, nga ana e djathtë ulet zëvendësi i kryetarit të Gjykatës, kryetarët e sektorëve ulen në mënyrë alternative sipas radhitjes nga e djathta dhe majtas sipas radhitjes së zgjedhjes në Gjykatë dhe ai rregull vazhdon edhe për vendin e uljes së gjyqtarëve. Çdo gjyqtarë ulet saktë në

vendin e caktuar dhe para tij qëndron tabelë me emrin e Gjykatës dhe me emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit.

Administratori gjyqësor ulet nga ana e majtë afër kryetarit të Gjykatës.

Nëse në punën e Seancës së përgjithshme marrin pjesë edhe persona jashtë përbërjes së Seancës së përgjithshme, ata ulen pas përbërjes së Seancës së përgjithshme.

Neni 44

Në Seancën e përgjithshme është i pranishëm dhe merr pjesë në punën, pa të drejtë vote, administratori gjyqësor, a sipas nevojës edhe nëpunës tjerë profesionalë, me vendim të kryetarit të Gjykatës.

Kur kryetari i Gjykatës do të vlerësojë se është e nevojshme, posaçërisht kur Seanca e përgjithshme shqyrton çështje me interes të veçantë, mund të ftojë që në Seancën e përgjithshme të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e saj edhe përfaqësues nga gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 45

Seanca e përgjithshme e zgjeruar

Në Seancën e përgjithshme të zgjeruar, me vlerësim të kryetarit të Gjykatës ose me konkluzion të Seancës së përgjithshme, mund të ftohen që të marrin pjesë në punën edhe Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Avokati i Popullit, Avokati Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësues të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, fakultetet juridike ose fakultetet tjera, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve, ose institucione tjera profesionale që me çështjet nga fushëveprimi i tyre mund të japin mendimin dhe kontributin e vet.

Neni 46

Për Seancën e përgjithshme njoftohen dhe në atë mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të medimeve publike, nëse në seancën diskutohen çështje me kuptim më të gjerë që janë në interes të publikut.

Vendimin për praninë e përfaqësuesve të medimeve publike e miraton kryetari i Gjykatës.

Neni 47

Seancat e përgjithshme, sipas rregullit, mbahen në selinë e Gjykatës. Me përjashtim, me vendim të kryetarit të Gjykatës, Seancat e përgjithshme mund të mbahen edhe jashtë selisë së Gjykatës.

Neni 48

Seancën e përgjithshme e thërret kryetari i Gjykatës me vetiniciativë, me konkluzion të Seancës së përgjithshme ose me iniciativë të seancës së gjyqtarëve, sektorëve të Gjykatës, këshillave gjyqësor dhe gjyqtarit të Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës është i obliguar të thërrasë seancë të përgjithshme me konkluzion të seancës së përgjithshme, me kërkesë të një sektori të Gjykatës ose të seancës së gjyqtarëve.

Së bashku me kërkesën për thirrje të seancës së përgjithshme, nevojitet që të nënshtrohet çështja që duhet të shqyrtohet në seancën dhe të prononcohet mendimi për aktvendimin mbi atë çështje.

Neni 49

Ftesën për thirrjen e seancës së përgjithshme me propozim të rendit të ditës e përgatit administratori gjyqësor ose ndonjë nëpunës tjetër gjyqësor me urdhëresë të kryetarit të Gjykatës.

Ftesa për thirrjen e seancës së përgjithshme, me propozim të rendit të ditës dhe të gjitha materialet, u dorëzohet anëtarëve të seancës së përgjithshme dhe pjesëmarrësve tjerë, më së paku 10 ditë para mbajtjes së seancës.

Në raste urgjente, ai afat mund të jetë më i shkurtër.

Në rastin kur kryetari i Gjykatës thërret seancë të përgjithshme, me vetiniciativë në raste urgjente, obligohet që anëtarëve të seancës së përgjithshme, me ftesën t'u dorëzojë material me shkrim me propozimin e rendit të ditës.

Neni 50

Kryetari i Gjykatës e hap seancën dhe njofton se cilët gjyqtarë e kanë arsyetuar mungesën dhe kush është ftuar të marr pjesë në seancën.

Prania e gjyqtarëve në seancë të përgjithshme është obliguese.

Nga seanca e përgjithshme, gjyqtarët mund të mungojnë vetëm për shkaqe veçanërisht të arsyeshme, që i vlerëson kryetari i Gjykatës.

Neni 51

Kryetari i Gjykatës fillimisht konstaton nëse në seancën e përgjithshme janë të pranishëm së paku dy e treta e anëtarëve të seancës së përgjithshme, pastaj me votim miratohet rendi i ditës.

Rendi i ditës aprovohet kur për të do të voton shumica e gjyqtarëve të pranishëm.

Neni 52

Para miratimit të rendit të ditës ai mund të plotësohet me pikë të re mbi çështje drejtpërdrejtë të propozuara para mbajtjes së seancës ose në vetë seancë, nëse janë të karakterit të atillë që për ato nuk nevojitet përgatitje, por kërkohet urgjencë e veçantë. Urgjenca duhet të arsyetohet.

Çdo gjyqtar mund të kërkojë që rendi i propozuar i ditës të ndryshohet dhe të plotësohet dhe është i obliguar që atë propozim ta arsyetojë.

Nëse rendi i ditës ndryshon, së pari vendoset për propozimin që ndonjë pikë nga rendi i ditës të tërhiqet, pastaj për propozimin rendi i ditës të plotësohet me ndonjë pikë. Rendi i ditës së propozuar mund të plotësohet nëse shkaqet për atë janë shkaktuar që kur seanca e përgjithshme veç më ka qenë e thirrur dhe nëse gjyqtarët janë njoftuar me materialin për atë pikë të rendit të ditës.

Radhitjen për shqyrtimin e çështjeve mbi pikët e rendit të ditës së seancës së përgjithshme e përcakton kryetari i Gjykatës.

Kryetari i Gjykatës mund ta ndryshojë radhitjen për shqyrtimin e pikave individuale të rendit të ditës, ose ta bashkojë diskutimin për pika individuale të rendit të ditës.

Neni 53

Seanca e përgjithshme punon nëse në seancë janë të pranishëm të paktën dy e treta e anëtarëve të seancës së përgjithshme.

Seanca e përgjithshme sipas rregullit vendos në mënyrë të vlefshme me shumicën e votave nga gjyqtarët që e përbëjnë seancën e përgjithshme.

Neni 54

Votimi në seancën e përgjithshme është publike, ndërsa votimi është sekret kur për atë do të vendosë seanca e përgjithshme, me propozim të një anëtari të seancës së përgjithshme.

Neni 55

Mbi çështjet e rendit të ditës votohet që kur Seanca e përgjithshme do të prononcohet se mbi atë çështje është diskutuar mjaft.

Votimi bëhet ashtu që anëtarët e pranishëm në seancën e përgjithshme prononcohen me “për” ose “kundër” propozimit.

Nëse ka më shumë propozime, së pari votohet për propozimin e referuesit, pastaj për propozimet tjera, siç janë propozuar në seancën e përgjithshme.

Anëtarët e Seancës së përgjithshme nuk mund të refuzojnë të votojnë ose të jenë të përmbajtur nga votimi.

Neni 56

Votimi bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa me përjashtim edhe sipas emrit, nëse ashtu vendos seanca e përgjithshme.

Kur votohet me ngritjen e dorës, me thirrje të kryetarit të Gjykatës, përkatësisht kryesuesit të seancës, së pari votojnë anëtarët e seancës së përgjithshme që janë për propozimin.

Pas votimit për propozimin, kryetari i Gjykatës, përkatësisht kryesuesi i seancës i thërret të votojnë edhe anëtarët e seancës së përgjithshme që janë kundër propozimit.

Kryetari i Gjykatës, përkatësisht kryesuesi i seancës konstaton nëse për pranimin e propozimit kanë votuar shumica nga anëtarët e Seancës së përgjithshme.

Neni 57

Sipas emrit votohet nëse për atë propozon ndonjë nga anëtarët e seancës së përgjithshme dhe nëse ashtu vendos seanca e përgjithshme me shumicë të votave nga të gjithë anëtarët e pranishëm në seancën e përgjithshme.

Sipas emrit votohet me thërritje të anëtarëve të seancës së përgjithshme sipas radhitjes së uljes, me atë që gjyqtari referues çdoherë voton i pari.

Neni 58

Kur mbi çështje individuale bëhet votimi sekret, rezultatin nga votimi e konstaton komision tre anëtarësh që e emëron seanca e përgjithshme nga anëtarët e vet, përmes shortit. Administratori gjyqësor, shefi i kabinetit ose ndonjë i punësuar tjetër në kabinetin e kryetarit të Gjykatës ndihmon në punën e komisionit.

Votimi sekret bëhet me fletëvotimi. Në fletëvotim duhet qartë të përcaktohet çështja mbi të cilën votohet. Votohet ashtu që rrethohet fjala “për” ose “kundër”.

Neni 59

Pasi seanca e përgjithshme ta miratojë rendin e ditës, kryetari i Gjykatës, përkatësisht kryesuesi i seancës, për çdo pikë të rendit të ditës, i jep fjalë së pari gjyqtarit referues. Në diskutim, kryetari i Gjykatës u jep fjalë pjesëmarrësve sipas radhitjes sipas së cilës janë lajmëruar për diskutim.

Në seancë mbi propozim-qëndrimet parimore, përkatësisht propozim-mendimet juridike parimore dhe çështje tjera të diskutuara në seancë të përgjithshme, së pari mendimin e jep gjyqtari referues ose gjyqtari me propozimin e të cilit çështja është vënë për shqyrtim në seancë të përgjithshme.

Të gjithë anëtarët e pranishëm të seancës së përgjithshme mund të marrin pjesë në diskutimin, që mund të kufizohet për kohë të caktuar.

Nëse një anëtar i seancës së përgjithshme dëshiron të flasë për shkelje të Rregullores, ose të përgjigjet për pretendimin lidhur me mendimin e dhënë nga ai i cili e ka shkaktuar papajtueshmërinë, kryetari i Gjykatës ia jep fjalën menjëherë sapo ta kërkojë.

Neni 60

Kryetari i Gjykatës, përkatësisht kryesuesi i seancës e mbyll diskutimin mbi pikat e veçanta të rendit të ditës atëherë, kur do të konstatojë se mbi atë çështje janë përfshirë të gjitha diskutimet dhe janë plotësuar kushtet për vendimmarrje ose kur seanca e përgjithshme do të prononcohet për atë.

Seanca e përgjithshme mund të vendosë që të shtyhet marrja e qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor, përkatësisht marrja e vendimit mbi çështje individuale në qoftë se konsideron se për çështje individuale nuk janë përfshirë të gjitha diskutimet ose për arsye tjera të posaçme nuk janë plotësuar kushtet për vendimmarrje, dhe sipas nevojës mund që ndonjë çështje individuale të largojë nga rendi i ditës.

Propozuesi mund ta tërheq propozimin për qëndrimin parimor ose mendimin juridik parimor, pa obligim që përsëri ta propozojë për diskutim dhe vendimmarrje në seancë të përgjithshme.

Neni 61

Për rrjedhën e seancës së përgjithshme mbahet procesverbal.

Procesverbali i përfshin informacionet themelore për seancën e përgjithshme dhe informacionet nga puna e saj.

Procesverbalin për seancën e përgjithshme e udhëheq administratori gjyqësor, ose nëpunësi gjyqësor i përcaktuar me vendim të kryetarit të Gjykatës.

Procesverbali në formë elektronike futet në dosje të posaçme që është në dispozicion për të gjithë gjyqtarët.

Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari i Gjykatës dhe procesverbalisti.

Rrjedha e seancës incizohet dhe përgatitet tekst integral.

Neni 62

Kur seanca e përgjithshme vendos mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, referatin dhe vendimin i përgatit gjyqtari referues, ndërsa procesverbali për këshillim me vendimin e miratuar mbi kërkesën nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm të seancës.

Qëndrimet parimore të miratuara dhe mendimet juridike parimore, si dhe vendimet tjera të pranuar futen në procesverbalin në tekst integral, ashtu siç kanë qenë të votuara në seancën e përgjithshme.

Në procesverbalin futen edhe rezultatet nga votimi për çështjet dhe propozimet e veçanta.

Çdo anëtar i seancës së përgjithshme që nuk është pajtuar me qëndrimin parimor të miratuar dhe me mendimin juridik parimor, si dhe me vendimin e pranuar, mund të kërkojë që pjesët thelbësore nga mendimi i tij të futen në procesverbalin ose ndaj procesverbalit të bashkëngjitet mendimi i veçuar i tij.

Procesverbalit i bashkëngjitet edhe gjedhja e qëndrimit parimor i miratuar dhe mendimi juridik parimor ose vendimi i pranuar nga seanca e përgjithshme.

Neni 63

Seanca e përgjithshme miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Qëndrimi parimor paraqet qëndrim që e miraton Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi çështje me kuptim për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Mendimi juridik parimor është qëndrim i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështje të caktuar, për të cilën në seancën e përgjithshme është marrë qëndrim për shkak të praktikës jo të njësuar në zbatimin e ligjeve.

Neni 64

Propozim për diskutim dhe miratim të qëndrimeve parimore ose mendimeve juridike parimore, mund të japin sektorët e Gjykatës për sferën juridike të cilës i referohet çështja juridike.

Kur flitet për çështje që i prek punët e të gjithë sektorëve, sektorët paraprakisht i përshtatin qëndrimet e veta. Nëse qëndrimet e sektorëve nuk janë të përshtatura, me propozimin për seancë të përgjithshme të njërit sektor, theksohen edhe qëndrimet e kundërta të sektorëve tjerë.

Me propozim të një gjyqtari të Gjykatës, kryetari i Gjykatës e parashton çështjen e caktuar në seancë të përgjithshme, nëse gjyqtari bën referat me shkrim, me propozim konkret për vendosjen e çështjes kontestuese.

Neni 65

Qëndrimet parimore të miratuara dhe mendimet juridike parimore dhe konkluzionet e miratuara përfshijnë edhe arsyetimin në të cilin theksohen shkaqet për miratimin e tyre.

Arsyetimin e qëndrimeve parimore të miratuara, mendimeve juridike parimore, të vendimeve, konkluzioneve tjera dhe të gjitha vendimeve që i miraton seanca e përgjithshme, i përgatit gjyqtari referues në afat prej 15 ditësh pas përfundimit të

seancës së përgjithshme dhe ai publikohet në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mendimi i veçuar i gjyqtarit, anëtar i seancës së përgjithshme, nuk publikohet.

Neni 66

Qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore, si dhe konkluzionet që janë miratuar dhe nxjerrë në seancën e përgjithshme, janë obliguese për të gjithë këshillat e Gjykatës, përkatësisht gjyqtarët dhe kryetarin e Gjykatës.

Neni 67

Seanca e përgjithshme jep mendim mbi propozime të ligjeve dhe të rregullave tjera, me të cilat rregullohen çështje me kuptim për punën e gjykatave, drejtuar parashtresit të ligjit përkatësisht rregullës.

Neni 68

Seanca e përgjithshme emëron anëtarë të Këshillit për vendimmarrjen e ankesave kundër vendimeve të miratuara nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e gjyqtarit ose për masë të shqiptuar disiplinore.

Seanca e përgjithshme i përcakton anëtarët e Këshillit për vendimmarrjen e ankesave nga Gjykata me sistem të shortit nga radha e gjyqtarëve, përveç kryetarit të Gjykatës.

Gjatë zbatimit të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit për vendimmarrjen e ankesës, seanca e përgjithshme shortin e bën në mënyrë që sipas numrit të anëtarëve të seancës së përgjithshme vendosen zarfe të mbyllura me fletë, nga të cilat tre janë të shënuara me “kryetar i këshillit”, “gjyqtar referues” dhe “anëtar i këshillit”.

Zarfe të mbyllura vendosen edhe për gjyqtarët që mungojnë, ato hapen dhe kjo konstatohet në procesverbal.

Gjyqtari mund të kërkojë të jetë i përjashtuar nga pjesëmarrja në këtë këshill, me kërkesë të arsyetuar dorëzuar më së voni para mbajtjes së Seancës së përgjithshme, për të cilën do të prononcohet Seanca e përgjithshme.

Kryetari i Gjykatës e shpall përbërjen e Këshillit për vendimmarrjen e ankesës me anëtarët e emëruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe anëtarët tjerë nga gjykatat tjera.

Kryetari i Gjykatës sjell vendim me shkrim për përbërjen e Këshillit për vendimmarrjen e ankesës që dorëzohet te të gjithë anëtarët e Këshillit, ndërsa lënda mbi të cilën duhet të vendos Këshilli për vendimmarrjen e ankesës i dorëzohet kryetarit të Këshillit.

Neni 69

Seanca e përgjithshme vendos për kundërshtimin e gjyqtarit të gjykatës më të ulët, kundër vendimit të orarit vjetor të punës, të miratuar nga kryetari i Gjykatës.

Gjyqtar referues mbi kundërshtimin e gjyqtarit nga gjykata më e ulët është gjyqtari që me vendim të kryetarit të Gjykatës është përcaktuar me orarin vjetor që ta ndjekë punën e asaj gjykate, që e përgatit vendimin.

Në qoftë se është parashtruar kundërshtim nga një gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ai personalisht e arsyeton në seancën e përgjithshme, ndërsa vendimin e miratuar mbi kundërshtimin e përgatit gjyqtari që do të caktohet nga seanca e përgjithshme.

Neni 70

Raportet vjetore të punës së gjykatave shqyrtohen në seancë të përgjithshme të zgjeruar gjatë muajit mars.

Në seancën e përgjithshme ku duhet të shqyrtohen raportet ftohen edhe kryetarët e Gjykatës së Lartë Administrative, të Gjykatës Administrative, kryetarët e gjykatave të apelit, kryetarët dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe në raste individuale edhe kryetarët e të gjitha gjykatave ose të gjykatave individuale themelore, a njoftohen edhe mediumet.

Seanca e përgjithshme, pas shqyrtimit të punës së çdo gjykate, jep vlerësimin e vet si konkluzion lidhur me përditësimin dhe cilësinë e punës së gjykatës.

Vlerësimet dhe konkluzionet e seancës së përgjithshme u dorëzohen gjykatave dhe publikohen në ueb-faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e përgjithshme me programin e punës përcakton nëse gjatë vitit veçanërisht do ta ndjekë punën e një gjykate të veçantë dhe do të përcaktojë një gjyqtar ose një grup të gjyqtarëve që do ta realizojnë atë.

12. SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Neni 71

Sektori i praktikës gjyqësore e ndjek dhe e studion praktikën gjyqësore, inicion shqyrtimin e mendimeve juridike të miratuara dhe propozon që në seancë të përgjithshme për çështje juridike të veçantë të merret qëndrim.

Sektori i praktikës gjyqësore organizon takime me gjykatat e apelit mbi shqyrtimin e çështjeve juridike të caktuara për unifikimin çështjeve juridike të caktuara.

Sektori i praktikës gjyqësore e ndjek edhe praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Neni 72

Në Sektorin e praktikës gjyqësore mbahet edhe libër i posaçëm ku futen qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore të miratuara në seancë të përgjithshme, mendimet juridike të miratuara në seancat e sektorëve, konkluzionet e këshillimeve dhe takimeve punuese të gjyqtarëve.

Neni 73

Nëse kryetari i Sektorit të praktikës gjyqësore ose nëpunësit profesionalë gjyqësor të obliguar për praktikën gjyqësore me vërejtje të arsyetuar me shkrim, sugjerojnë se në vendimin e miratuar është bërë shmangia e qëndrimit parimor ose të mendimit juridik parimor, të mendimeve juridike të miratuara dhe konkluzioneve të sektorëve dhe të praktikës gjyqësore, kryetari i këshillit përsëri e paraqet lëndën në seancë të këshillit.

Nëse këshilli e ndryshon vendimin, lënda i dorëzohet kryetarit të sektorit për shkak të paraqitjes së lëndës në seancë të sektorit përkatës.

Nëse seanca e sektorit konsideron se në vendimin është shmangur qëndrimi parimor i miratuar ose mendim juridik parimor dhe mendime juridike të miratuara dhe konkluzione të sektorëve dhe të praktikës gjyqësore, do ta kthejë lëndën te këshilli që veç më e ka miratuar vendimin, për vendimmarrje tjetër.

Nëse këshilli qëndron me vendimin e vet, lënda dorëzohet në seancë të përgjithshme, në pajtim me dispozitat e punës së seancës së përgjithshme.

13. MBLEDHJE DHE KËSHILLIME

Neni 74

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me vetiniciativë ose me kërkesë të gjykatave, organizon këshillime ose mbledhje konsultative me gjyqtarët e gjykatave, për vendosje të çështjeve kontestuese juridike dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

14. TRANSPARENCA NË PUNËN E GJYKATËS

Neni 75

Transparenca në punë sigurohet me publikimin e vendimeve të Gjykatës dhe informacioneve më të rëndësishme lidhur me punën e Gjykatës në ueb-faqen, me dorëzimin e njoftimit zyrtar nëpërmjet mjeteve për informim publik, mbajtjes së konferencave për medie, si dhe me botimin e buletineve dhe në mënyra tjera.

Neni 76

Të gjitha vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut publikohen në ueb-faqen e Gjykatës.

Neni 77

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut mban konferenca për medie me përfaqësues të akredituar të mjeteve për informim publik me rastin e raportit vjetor të punës së Gjykatës.

Konferenca për medie mbahet edhe në raste tjera kur Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vlerëson se bëhet fjalë për çështje në interes të publikut.

Konferencën për medie e cakton dhe e udhëheq kryetari i Gjykatës, ndërsa akreditimet e përfaqësuesve nga mjetet për informim publik lëshohen nga një person i caktuar nga kryetari i Gjykatës.

Neni 78

Për vendimet e Gjykatës për të cilat ka interes në publik, Gjykata jep njoftime për publikun.

Njoftimin për publikun e përpilon zëdhënësi i Gjykatës, ndërsa e miraton kryetari i Gjykatës ose një person të cilin ai do ta autorizojë.

Neni 79

Në rastin kur informacioni lidhur me vendimin, përkatësisht me punën e Gjykatës është i pavërtetë, i paplotë ose është transmetuar gabimisht, Gjykata mund të kërkojë, që në pajtim me ligjin, të publikohet përgjigje ose korrigjim.

15. NDALIMI I SHPREHJES PUBLIKE PËR LËNDËN

Neni 80

Gjyqtarët nuk guxojnë që publikisht të shprehin mendimin e tyre lidhur me lëndën për të cilën vendoset në Gjykatë.

4. PUBLIKIMET E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 81

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut boton Buletin të praktikës gjyqësore dhe Përmbledhje të vendimeve gjyqësore në të cilat botohen qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore të miratuara në seancë të përgjithshme, mendime juridike dhe konkluzione të sektorëve gjyqësor, vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të institucioneve tjera ndërkombëtare, me rëndësi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sentenca nga vendimet e Gjykatës të miratuara në seancat e sektorëve, punime profesionale dhe akte tjera me kuptim për organizimin, rregullimin dhe funksionimin e Gjykatës.

Redaktorin dhe përgjegjës të kryesor të Buletinit të praktikës gjyqësore dhe Përmbledhjes së vendimeve gjyqësore të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetarin dhe anëtarët e Bordit Redaktues i cakton kryetari i Gjykatës me vendim.

17. NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË RREGULLORES SË PUNËS

Neni 82

Rregullorja ndryshohet dhe plotësohet në mënyrën në të cilën miratohet.

Propozim për ndryshim dhe plotësim të rregullores mund të parashtrojnë kryetari i Gjykatës dhe gjyqtarët.

Propozimi parashtrohet në formë të shkruar dhe doemos të jetë i arsyetuar.

18. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 83

Dispozita e nenit 29, paragrafi (1) të kësaj rregulloreje do të zbatohet që kur të sigurohen burime njerëzore dhe teknike.

Neni 84

Nga dita kur hyn në fuqi kjo rregullore, ndërpritet të vlejë Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.13/98) dhe rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.21/09).

Neni 85

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**ПРЕТСЕДАТЕЛ НА ВРХОВНИОТ СУД НА
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Besa Ademi